



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Akte të papublikuara

1997

Ekstra 19

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.202, datë 9.5.1997	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 2.2.1996 “Për listën e barnave që rimbursohen dhe masën e mbulimit të çmimit të barnave”.....	3
Vendim i KM nr.203, datë 8.5.1997	Për tarifat e ujit të pijshëm.....	4
Vendim i KM nr.204, datë 8.5.1997	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.812, datë 25.11.1996 “Për moszbatimin e kamatëvonesës për konsumatorët familjarë”.....	4
Vendim i KM nr.208, datë 8.5.1997	Për përballimin e shpenzimeve të transportit për mësuesit dhe nxënësit që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit.....	5
Vendim i KM nr.217, datë 24.5.1997	Për dhënien me qira të depove të karburanteve të ushtrisë.....	5
Vendim i KM nr.218, datë 25.5.1997	Për miratimin e vendosjes në Shqipëri të ekipeve të ndihmës logjistike për ushtrinë.....	6

Vendim i KM nr.220, datë 25.5.1997	Për miratimin e një grupi projektsh të financuara nga UNDP.....	6
Vendim i KM nr.222, datë 24.5.1997	Për miratimin e marrëveshjes me koncesion të formës “BOT” për hidrocentralin e Kalivaçit.....	7
Vendim i KM nr.223, datë 25.5.1997	Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure ndërmjet sh.a. ALBPETROL dhe grupit të kompanive të përbërë nga KITARI, OIL, PTY, LTD DRILLSEARCH ENERGY N.L DHE KIWI INTERNATIONAL RESOURCES LTD për kryerjen e operacioneve hidrokarbure për rehabilitimin e vendburimeve ekzistuese të Ballsh-Hekalit dhe Cakran-Mollajt.....	8
Vendim i KM nr.225, datë 24.5.1997	Për kalimin e industrisë së bakrit në regjim të përkohshëm konservimi.....	8
Vendim i KM nr.229, datë 7.6.1997	Për një ndryshim në kuotën financiare ushqimore të studentëve të shkollave të larta.....	9
Vendim i KM nr.246, datë 14.6.1997	Për miratimin në parim të disa ndryshimeve të marrëveshjes për projektin “Mbështetja për hedhjen e bazave të veprimtarisë sipërmarrëse”.....	10
Vendim i KM nr.247, datë 14.6.1997	Për ndërtimin e silloseve të drithërave në portin detar të Durrësit	10
Vendim i KM nr.258, datë 14.6.1997	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.371, datë 20.5.1996.....	11
Vendim i KM nr.262, datë 23.6.1997	Për përballimin e shpenzimeve të ndërmarrjeve në proces likuidimi dhe privatizimi.....	11
Vendim i KM nr.267, datë 19.6.1997	Për përjashtimin nga taksat doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të makinerive, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për montimin e tyre, që importohen për t’u investuar.....	12
Vendim i KM nr.282, datë 4.7.1997	Për shpalljen objekt të rëndësishëm shtetëror të Pallatit të Kongreseve.....	14
Vendim i KM nr.291, datë 7.7.1997	Për strukturën dhe organikën e Sekretariatit Ekzekutiv të Komitetit Shqiptar të Birësimeve.....	14
Vendim i KM nr.325, datë 22.8.1997	Për caktimin e personave juridikë që do t’i nënshtrohen dispozitave të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””.....	16
Vendim i KM	Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.....	18

nr.335, datë 2.9.1997

Vendim i KM nr.358, datë 10.9.1997	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.694, datë 21.10.1996 “Për normën mësimore-shkencore në shkollat e larta dhe në arsimin parauniversitar, pagimin e orëve suplementare, aktivizimin e pensionistëve dhe punonjësve të jashtëm në sistemin e arsimit”.....	21
Vendim i KM nr.393, datë 26.9.1997	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 23.1.1995 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.....	21
Vendim i KM nr.396, datë 26.9.1997	Për detyrat e grupit mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.....	22
Vendim i KM nr.397, datë 26.9.1997	Për miratimin në parim të Memorandumit të Mirëkuptimit për Misionin e Asistencës doganore të Komisionit European në Shqipëri.....	24
Vendim i KM nr.398, datë 26.9.1997	Për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.99, datë 24.2.1997 “Për përcaktimin e disa kriterëve lokale për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve që janë në vështirësi ekonomike”.....	24
Vendim i KM nr.429, datë 20.10.1997	Për miratimin e protokollit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës të Greqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.....	25
Vendim i KM nr.455, datë 20.10.1997	Për miratimin dhe zbatimin e programit operacional të vendit (COP) për vitin 1997 në kuadrin e programit kombëtar PHARE të Komisionit European.....	26
Vendim i KM nr.456, datë 20.10.1997	Për miratimin e grantit japonez për përgatitjen e projektit “Rimëkëmbja e industrisë private”, që financohet nga Banka Botërore.....	27
Vendim i KM nr.481, datë 10.11.1997	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.208, datë 8.5.1997 “Për përballimin e shpenzimeve të transportit për mësuesit dhe nxënësit që punojnë dhe mësojnë jashtë vendbanimit”.....	28
Vendim i KM nr.483, datë 10.11.1997	Për miratimin e marrëveshjes së grantit italian ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA) , si administratore e fondeve grant për projektin e rrugëve rurale.....	28
Vendim i KM nr.502, datë 24.11.1997	Për pagimin e shumave dhe diferencave të pensioneve për periudhë të kaluar për të përndjekurit politikë.....	29
Vendim i KM nr.509, datë 24.11.1997	Për kompensimin e tokës bujqësore të zënë nga ndërtimet pa leje për familjet e fshatit Bulcesh.....	29
Vendim i KM nr.510, datë 24.11.1997	Për kriteret e vendosjes në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranim.....	30

Vendim i KM nr.513, datë 24.11.1997	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250, datë 16.4.1996 “Për procedurat e prioritetet në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha””	33
Vendim i KM nr.538, datë 4.12.1997	Për shpalljen e ujësjellësit të Bovillës si objekt i rëndësishëm shtetëror.....	33
Vendim i KM nr.549, datë 27.11.1997	Për importimin e kripës së gjellës së jodizuar dhe prodhimin e saj në vend.....	34

VENDIM
Nr.202, datë 9.5.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.54, DATË 2.2.1996 “PËR LISTËN E BARNAVE QË RIMBURSOHEN DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE”

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit dhe Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e mbulimit të çmimeve të listës së barnave kryesore që rimbursohen sipas grupeve është:

Grupi 100%

- Barna për mjekimin e sëmundjeve tumorale;
- Barna për mjekimin e sëmundjes së tuberkulozit.

Grupi II 75-99.9%

- Analgjezike dhe antipiretike;
- Antiinfektive;
- Antineoplazike;
- Antiparkinsonike;
- Kardiovaskulare;
- Dermatologjike;
- Hormone, kontraktivë, endokrinologji;
- Miorelaksant;
- Oftalmologji;
- Oksitocike dhe antioksidatocike;
- Psikotrope.

Veprojnë në rrugët e frymëmarrjes.

Vitamina e kripëra minerale.

Grupi III 55-74.9%

- Antialergjike;
- Antidote;
- Antiepileptike;
- Të hematologjisë;
- Gastrointestinal.

Grupi IV 37.5%-54.9%

Antimigrenoz;

Diuretike.

2. Pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54, datë 2.2.1996 “Për listën e barnave kryesore që rimbursohen dhe masën e mbulimit të çmimit të barnave”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 15.5.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.203, datë 8.5.1997

PËR TARIFAT E UJIT TË PIJSHËM

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat e ujit të pijshëm që do të zbatohen nga ndërmarrjet e ujësjellësve, për furnizimin e konsumatorëve të ndryshëm, do të jetë:

a) për konsumatorët familjarë me matës uji	15 lekë m ³
b) për konsumatorët familjarë pa matës uji me furnizim me ujë në banesë, por jo më shumë se 300 lekë për familje	60 lekë/muaj për banorë
c) për institucionet shëndetësore	15 lekë/m ³
ç) për institucionet arsimore	30 lekë/m ³
d) për prodhuesit e bukës	45 lekë/m ³
dh) për institucionet shtetërore	52 lekë/m ³
e) për kompanitë private	60 lekë/m ³
ë) për furnizim me ujë me çezma publike	80 lekë/muaj për familje.

2. Në rastet e verifikimit të konsumit të ujit mbi normativat në fuqi sipas kategorisë së konsumatorëve, diferenca e ujit të faturohet me 60 lekë/m³.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, si dhe organet e pushtetit lokal.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.905, datë 30.12.1996, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.204, datë 8.5.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.812, DATË 25.11.1996 “PËR MOSZBATIMIN E KAMATËVONESËS PËR KONSUMATORËT FAMILJARË”

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.812, datë 25.11.1996 “Për moszbatimin e kamatëvonesës për konsumatorët familjarë”, paragrafi i fundit, fjalët “gjer më 31 tetor 1996” të ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “gjer më 31 korrik 1997”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.208, datë 8.5.1997

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT PËR MËSUESIT DHE
NXËNËSIT QË PUNOJNË E MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet e transportit të mësuesve që punojnë jashtë periferisë së qytetit, por brenda rrethit, dhe kthehen brenda ditës, si dhe shpenzimet e transportit të nxënësve që për të ndjekur shkollën lëvizin në linja interurbane në distancat mbi 2 km, përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit.
 2. Këshillat e rretheve, me propozim të drejtorive arsimore, të përcaktojnë linjat për transportin e mësuesve dhe të nxënësve.
 3. Transporti i mësuesve dhe i nxënësve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet me mjetet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe personave fizikë a juridikë privatë.
 4. Autorizohet Ministria e Arsimit dhe Sporteve, duke u mbështetur edhe në mendimin e këshillit të rrethit, që për zona ku nuk ka linja të rregullta interurbane dhe që janë në rrugë të kategorisë së tretë e lart, të aplikojë një shtesë tarife prej 20% mbi tarifat e miratuara në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.307, datë 20.7.1992 "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", paragrafi 3 pika 2/g. Numri i linjave që përfitojnë sipas kësaj pike, të mos përbëjë më shumë se 15-20% të totalit të tyre.
 5. Efektet financiare për shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.
 6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
 7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, të gjitha dispozitat e Këshillit të Ministrave për transportin e mësuesve dhe nxënësve, shfuqizohen.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 maj 1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.217, datë 24.5.1997

PËR DHËNIEN ME QIRA TË DEPOVE TË KARBURANTEVE TË USHTRISË

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënia me qira për të tretët deri në një vit të depove të karburantit të ushtrisë, të mbetura përkohësisht të lira, bëhet nga Ministria e Mbrojtjes me miratim të Ministrisë së Privatizimeve.
2. Përcaktimi i qiramarrësit do të realizohet nëpërmjet ankandeve të hapura, të organizuara nga repartet ushtarake që i kanë në administrim depot e karburantit, të miratuara nga Ministria e Mbrojtjes për t'u dhënë me qira.
3. Tarifat minimale mujore për efekt ankandi për çdo m³ kapacitet bartës rezervuari që jepet me qira, të jenë:
 - a) Në qytetet Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Fushë-Krujë e Laç 3 dollarë USA.
 - b) Në rrethin Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier e Kurbin 2.5 dollarë USA.
 - c) Në qytetet që nuk përfshihen në pikën 3-a, 2.5 dollarë USA.
 - ç) Në rrethet që nuk përfshihen në pikën 3-b, 2 dollarë USA.
4. Të ardhurat nga qiradhënia e depove të karburantit të konsiderohen si të ardhura dytësore

për Ministrinë e Mbrojtjes.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.218, datë 25.5.1997

PËR MIRATIMIN E VENDOSJES NË SHQIPËRI TË EKIPEVE TË NDIHMËS
LOGJISTIKE PËR USHTRINË

Në bazë të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuesë”, neni 36, pika 2, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, për të përballuar nevojat emergjente dhe afatgjata të mbajtjes së ushtrisë, të marrë dhe të administrojë ndihma logjistike nga ushtritë e vendeve të tjera.

2. Të miratojë vendosjen e ekipeve të përkohshme për administrimin e ndihmave nga Italia, Turqia e Greqia, me përbërje 3-5 veta. Misioni i këtyre ekipeve të jetë koordinimi i pritjes dhe i shpërndarjes së ndihmave logjistike që këto vende kanë vënë në dispozicion.

3. Ministria e Mbrojtjes të këmbëjë letrat me ministrinë përkatëse të secilit vend, ku të përcaktohet statusi e misioni i këtyre ekipeve, koha e livrimit të ndihmave dhe koha e qëndrimit të ekipeve. Për çdo rast afati të mos kalojë 6 muaj, me të drejtë shtyrjeje edhe për 6 muaj të tjerë. Misioni i tyre të jetë mbajtja e lidhjeve dhe koordinimi për sjelljen dhe shpërndarjen e ndihmave.

Shpenzimet, e të gjitha llojeve, për sjelljen dhe akomodimin e ekipeve të ndihmës në Shqipëri të përballohen nga vendi dërgues.

4. Ministria e Mbrojtjes të ndjekë zbatimin e këtij vendimi dhe të marrë masa për pritjen e administrimin e ndihmave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.220, datë 25.5.1997

PËR MIRATIMIN E NJË GRUPI PROJEKTESH TË FINANCUARA NGA UNDP

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i masave të kontrollit kundër drogës”.

a) Miratohet marrëveshja e projektit dhe autorizohet Ministri i Brendshëm, ose i autorizuari i tij, për firmosjen e saj.

b) Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij projekti.

2. Miratimin e projektit “Dhënia e ndihmës së nevojshme Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e një masterplani në sistemin juridik”.

- a) Miratohet marrëveshja e projektit dhe autorizohet Ministri i Drejtësisë, ose i autorizuari i tij, për firmosjen e saj.
- b) Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij projekti.
3. Miratimin në parim të fazës së dytë të projektit “Partnerë në zhvillim”.
- a) Miratohet marrëveshja e projektit dhe autorizohet Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, ose i autorizuari i tij, për firmosjen e saj.
- b) Ngarkohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij projekti.
4. Miratimin e projektit “Përgatitja, formulimi, zbatimi dhe vlerësimi i projekteve për zhvillim”.
- a) Miratohet marrëveshja e projektit dhe autorizohet drejtori i Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe i Koordinimit të Ndhmës së Huaj për firmosjen e saj.
- b) Për zbatimin e projektit ngarkohet Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe i Koordinimit të Ndhmës së Huaj.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.222, datë 24.5.1997

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME KONCESION TË FORMËS “BOT” PËR
HIDROCENTRALIN E KALIVAÇIT**

Me propozimin e Ministrisë së Punës Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe të Ministrisë së Burimeve Minerare e Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe të Ministrisë së Burimeve Minerare e Energjetike, dhe shoqërisë italiane B.E.G. SpA për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit me koncesion të formës “BOT”, me përjashtim të neneve 8, 10, 24, 25, 30.

2. Shpronësimet e kupës së liqenit deri në kuotën 110 m mbi nivelin e detit dhe të zonës ku do të ndërtohet hidrocentrali i Kalivaçit, në përputhje me planorganizimin dhe projektin e veprave përfundimtare, do të bëhen nga këshilli i rrethit të Tepelenës në përputhje me ligjin nr.7848, datë 25.7.1994 “Për shpronësimet me interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”.

3. Financimi i shpronësimeve të pronave private do të përballohet nga shoqëria italiane B.E.G. SpA.

4. Të autorizojë shoqërinë B.E.G. SpA për të kryer me shpenzimet e saj studimin e bëshmërisë të hidrocentraleve të pjesës së poshtme të lumit Vjosë, mbas hidrocentralit të Kalivaçit.

Në rast se do të rezultojë nga studimi e do të miratohet nga Qeveria, ndërtimi i ndonjë hidrocentrali tjetër me koncesion sipas formës “BOT”, B.E.G. SpA ka të drejtën të jetë negociatori i parë.

5. Koncesionari lejohet të përdorë gratis materialet rrethimore në zonat demaniale dhe të hapë karriera për prodhim inertesh dhe argjilash në periudhën e ndërtimit të impiantit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.223, datë 25.5.1997

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES HIDROKARBURE NDËRMJET SHA ALBPETROL
DHE GRUPIT TË KOMPANIVE TË PËRBËRË NGA KITARI, OIL, PTY, LTD
DRILLSEARCH ENERGY N.L DHE KIWI INTERNATIONAL RESOURCES LTD PËR
KRYERJEN E OPERACIONEVE HIDROKARBURE PËR REHABILITIMIN E
VENDBURIMEVE EKZISTUESE TË BALLSH- HEKALIT DHE CAKRAN-MOLLAJT**

Në zbatim të nenit 13 pika 2 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet”, me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen hidrokarbure ndërmjet sh.a. Albpetrol dhe grupit të kompanive të përbërë nga Kitari, OIL, PTY, LTD, Drillsearch Energy N.L. dhe Kiwi International Resources LTD për kryerjen e operacioneve hidrokarbure për rehabilitimin e vendburimeve ekzistuese të Ballsh-Hekalit dhe Cakran-Mollajt.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.225, datë 24.5.1997

**PËR KALIMIN E INDUSTRIËS SË BAKRIT NË REGJIM TË PËRKOHSHËM
KONSERVIMI**

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Industria e bakrit të kalojë në regjim të përkohshëm konservimi. Fondet të përballohen nga fondet e konservimit të miratuara për vitin 1997 për Ministrinë e Burimeve Minerare dhe Energjetike, si dhe duke shtuar këtë zë për 12 milionë lekë nga pakësimi i investimeve për sektorin e gjeologjisë.

2. Punonjësit që do të dalin të lirë nga konservimi i përkohshëm i ndërmarrjeve përbërëse të industrisë së bakrit, të trajtohen e të paguhen në bazë të kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.420, datë 15.8.1994 “Për pagesën e punonjësve që dalin të tepërt nga procesi i ristrukturimit ose mbylljes së ndërmarrjeve apo pjesëve përbërëse të tyre, në vartësi të Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve , si dhe të disa ndërmarrjeve të tjera shtetërore me kushte të vështira për vazhdimin e mëtejshëm të veprimtarisë së tyre”, si dhe ndryshimeve të bëra me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.649, datë 23.9.1996 dhe udhëzimeve përkatëse me këtë ndryshim:

“Përfitojnë nga ky vendim punonjësit e këtyre sektorëve që dalin të papunë nga data 1.6.1997 deri në datën 1.7.1997. Nevojat për fonde financiare të përballohen nga fondet e akorduara për vitin 1997 Ministrisë së Privatizimeve për ARN”.

3. Me fillimin e punës gjithë punëtorët që do të trajtohen sipas pikës 2 të këtij vendimi, do të kthehen në punë.

4. Afati i mbylljes tërësore të disa minierave të bakrit që përcakton pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 6.11.1995 “Për mbylljen tërësore të disa minierave të bakrit”, shtyhet për vitin 1998. Fondet e përcaktuara për mbylljen e këtyre minierave për vitin 1997 kalojnë për konservimin e industrisë së bakrit.

5. Duke u bazuar në nenin 12 të ligjit nr.8222, datë 14.5.1997 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin

1997”, ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike, të bëjnë ndryshimet sipas pikës 1 të këtij vendimi.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Privatizimeve.

7. Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike, brenda muajit qershor të vitit 1997, të paraqesë në Këshillin e Ministrave platformën për ecurinë e mëtejshme të industrisë së bakrit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtin efektet nga data 1.4.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.229, datë 7.6.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË KUOTËN FINANCIARE USHQIMORE TË STUDENTËVE TË SHKOLLAVE TË LARTA

Me qëllim që të ruhet niveli i trajtimit me ushqim të studentëve në mencat e shkollave të larta në kushtet e rritjes aktuale të çmimeve, me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit e Tregtisë dhe të Ministrisë së Arsimit të Lartë e Kërkimeve Shkencore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota ushqimore ditore për trajtimin e të gjitha kategorive të studentëve të shkollave të larta, kur trajtohen në mensat e NTT Studentëve, gjatë periudhës 15 maj gjer më 31 korrik 1997 të rritet 40 lekë në krahasim me atë të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.654, datë 30.9.1996.

2. Efekti ekonomik për 5 milionë lekë të përballohet nga buxheti i miratuar për subvencionimin e NTT Studentëve për vitin 1997.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Arsimit të Lartë e Kërkimeve Shkencore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.246, datë 14.6.1997

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DISA NDRYSHIMEVE TË MARRËVESHJES PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJA PËR HEDHJEN E BAZAVE TË VEPRIMTARISË SIPËRMARRËSE”

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të disa ndryshimeve të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Mbështetja për

hedhjen e bazave të veprimtarisë sipërmarrëse” të datës 5 korrik 1994.

2. Për ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes të këtij projekti ngarkohet Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.

3. Për zbatimin e procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje autorizohet Ministria e Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.247, datë 14.6.1997

PËR NDËRTIMIN E SILLOSEVE TË DRITHËRAVE NË PORTIN DETAR TË DURRËSIT

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërtimin në portin detar të Durrësit të silloseve të drithërave me kapacitet 15 deri në 20 000 tonë.

2. Përcaktimi i firmës që do të realizojë këtë investim me burimet financiare të veta, do të bëhet me tender të hapur mbi bazën e procedurave ligjore në fuqi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.258, datë 14.6.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.371, DATË 20.5.1996

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të shfuqizohet pika 5 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.371, datë 20.5.1996.

2. Miratohet krijimi i njësisë së zbatimit të projektit të rrugëve kombëtare sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij vendimi. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për organizimin dhe funksionimin e njësisë së zbatimit të projektit.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit që, nëpërmjet njësisë së zbatimit të projektit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të zbatojë projektin e rrugëve

kombëtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË RRUGËVE KOMBËTARE

Njësia e zbatimit të projektit të rrugëve kombëtare përbëhet si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|--|
| 1. Kryetari i NjZP-së | Ministri i Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit; |
| 2. Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Financave; |
| 3. Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë; |
| 4. Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit; |
| 5. Anëtar | Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. |

VENDIM **Nr.262, datë 23.6.1997**

PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË NDËRMARRJEVE NË PROCES LIKUIDIMI DHE PRIVATIZIMI

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për përballimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore, që lidhen me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve, akordohen 170 milionë lekë nga fondi i kontingjencës.

2. Përdorimi i tyre për ndërmarrjet e vartësisë nacionale dhe atyre lokale do të bëhet duke respektuar kufijtë e miratuar sipas pasqyrës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

3. Akordimi i fondeve për çdo ndërmarrje nga ministritë dhe Sekretariati i Pushtetit Lokal, sipas vartësisë, bëhet vetëm mbasi të jenë analizuar me përgjegjësi faktorët e tejkalimit të afatit dhe të jenë përcaktuar shkaktarët.

Për ndërmarrjet e paraqitura në listat e ministrive dhe të Sekretariatit të Pushtetit Lokal, afati përfundimtar i financimit të jetë data 30.6.1997. Ngarkohet Ministria e Privatizimeve dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit të marrin masat e nevojshme për respektimin e afateve dhe procedurave të privatizimit.

Pas kësaj date çdo financim do të konsiderohet i paligjshëm.

4. Ministritë dhe Sekretariati i Pushtetit Lokal, të respektojnë afatin 6-mujor të zgjatjes së procesit të likuidimit për ndërmarrjet ose pjesët që kalojnë në privatizim, duke filluar që nga data e dorëzimit të dokumentacionit në Ministrinë e Privatizimeve.

Financimi mbas këtij afati i ngarkon ato me përgjegjësi.

5. Pika II/3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.186, datë 18.3.1996, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

FONDET E AKORDUARA PËR PROCESIN E LIKUIDIMIT SIPAS MINISTRIVE

1. Ministria e Privatizimit	30 milionë lekë
2. Ministria e Bujqësisë	37 milionë lekë
3. Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike	14 milionë lekë
4. Ministria e Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit	1 milionë lekë
5. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë	8 milionë lekë
6. Ministria e Mbrojtjes	4 milionë lekë
7. Sekretariati i Pushtetit Lokal	76 milionë lekë

VENDIM
Nr.267, datë 19.6.1997

PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR TË MAKINERIVE, PAJISJEVE DHE MATERIALEVE TË NEVOJSHME PËR MONTIMIN E TYRE, QË IMPORTOHEN PËR T'U INVESTUAR

Në mbështetje të nenit 2 të ligjit nr.8211, datë 23.4.1997 “Për përjashtimin e përkohshëm nga taksat doganore dhe TVSH-ja të disa importeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtohen nga taksat doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të gjitha makineritë, pajisjet dhe materialet e nevojshme për montimin e tyre, që importohen për t'u investuar në një nga veprimtaritë e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi. Importimi bëhet nga vetë investitori ose nëpërmjet ndonjë sipërmarrësi. Investitori duhet të jetë person juridik i regjistruar në Shqipëri.

2. Do të përfitojnë lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi vetëm makineritë dhe pajisjet që i takojnë linjës teknologjike apo që lidhen drejtpërsëdrejti me procesin teknologjik përkatës.

3. Për qëllime vetëm të zbatimit të dispozitave të këtij vendimi:

a) Me fjalën “makinë” do të kuptohet çdo konstruksion i krijuar prej njeriut që, duke marrë energji në një formë të përshtatshme, si dhe instruksionet e duhura, është në gjendje të kryejë punë në kuptimin më të gjerë të fjalës. Një sistem makinash të lidhura sipas ndonjë skeme të përcaktuar përbëjnë atë që quhet makineri;

b) Me shprehjen “linjë teknologjike” do të kuptohet tërësia e makinerive dhe pajisjeve që do të nevojiten për të realizuar procesin teknologjik në fushën përkatëse ku do të bëhet investimi;

c) Me shprehjen “proces teknologjik” do të kuptohet tërësia e mënyrave dhe metodave që duhet të ndiqen hap pas hapi për të bërë të mundur kryerjen e qëllimit, për të cilën bëhet investimi përkatës;

d) Me fjalën “pajisje” do të kuptohen pajisjet dhe aparaturat që shërbejnë si plotësues të makinerive dhe që ndihmojnë për funksionimin normal të tyre, si dhe për matjen dhe kontrollin e parametrave të punës;

e) Me shprehjen “materiale të nevojshme për montimin e makinerive dhe pajisjeve” do të kuptohen të gjitha materialet e tilla, si kablo, tubacione, rakorderi, termoizolues, dado e bulona, elektroda saldimi, shirita izolues elektrikë, ngjitës, bojëra llak e të tjera si këto, të cilat importohen në sasi të arsyeshme për t'u trupëzuar në linjën teknologjike. Nuk do të përfshihen në këtë përcaktim materialet e nevojshme për ndërtimin a përgatitjen e mjediseve ose bazamenteve ku do të montohen makineritë dhe pajisjet që përbëjnë linjën teknologjike.

4. Investimet që përfitojnë nga lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, janë:

a) në prodhim, me të cilin do të kuptohet instalimi i makinerive, pajisjeve dhe linjave teknologjike për të realizuar shfrytëzimin e pasurive natyrore, rritjen e bimëve dhe të kafshëve dhe përpunimin industrial të lëndëve të para;

b) në ndërtim, me të cilin do të kuptohet ngritja e parkut të makinerive dhe pajisjeve të nevojshme për të realizuar sipërmarrje ndërtimore;

c) në shërbimet në telekomunikacion, me të cilat do të kuptohet instalimi i centraleve, sistemeve të antenave dhe linjave dhe aparatrave të nevojshme për të realizuar telekomunikim masiv;

d) në shërbimet bankare, me të cilat do të kuptohet instalimi i rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve të sigurisë;

e) në shërbimet e natyrës komunale për furnizimin e popullsisë me ujë, me të cilin do të kuptohet instalim i impianteve të pompimit dhe pastrimit të ujit, shtrimi i linjave të furnizimit dhe vendosja e aparateve matëse.

f) në shërbimet e natyrës komunale për furnizimin e popullsisë me energji elektrike, me të cilat do të kuptohet instalimi i transformatorëve, shtrirja e rrjetit të furnizimit dhe shpërndarja e vendosja e aparateve matëse.

5. Makineritë dhe pajisjet që kanë fituar lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të regjistrohen në llogarinë e mjeteve themelore të investitorit dhe, për çdo ndryshim të gjendjes së tyre kontabël a fizike, duhet të njoftohen organet doganore dhe tatimore kompetente.

6. Makineritë dhe pajisjet që ndodhen në regjistrin e lejimit të përkohshëm, në qoftë se deklarohen për t'u zhdoganuar për qarkullim të lirë, përfitojnë nga lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, në qoftë se plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara më lart.

7. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimet përkatëse për procedurat që duhet të ndiqen në doganë për të përfutur nga lehtësitë në fjalë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtin efektet nga data 15.5.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.282, datë 4.7.1997

PËR SHPALLJEN OBJEKT TË RËNDËSISHËM SHTETËROR TË PALLATIT TË KONGRESEVE

Në mbështetje të nenit 3 germa a të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992 "Për policinë e objekteve", me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deri në përfundim të procesit zgjedhor, objekti "Pallati i Kongreseve", ku zhvillon aktivitetin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpallet objekt i rëndësishëm shtetëror.

2. Ministria e Brendshme të marrë menjëherë masat e nevojshme për ruajtjen e objektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.291, datë 7.7.1997

PËR STRUKTURËN DHE ORGANIKËN E SEKRETARIATIT EKZEKUTIV TË KOMITETIT SHQIPTAR TË BIRËSIMEVE

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.469, datë 14.8.1995 “Për kompetencat për emërimin dhe largimin nga detyra të drejtorëve të drejtorive në ministri e institucione të tjera qendrore dhe për ndryshimet në strukturat e tyre”, dhe me propozim të Sekretariatit Ekzekutiv të Komitetit Shqiptar të Birësimeve, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Struktura e Sekretariatit Ekzekutiv të Komitetit Shqiptar të Birësimeve të jetë sipas skemës 1 bashkëlidhur.
2. Organika e Sekretariatit Ekzekutiv të Komitetit Shqiptar të Birësimeve të jetë sipas skemës 2 bashkëlidhur.
3. Numri i punonjësve të Sekretariatit Ekzekutiv të Komitetit Shqiptar të Birësimeve do të jetë gjithsej 10 vetë.
4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti aktual i Sekretariatit Ekzekutiv të Komitetit Shqiptar të Birësimeve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

**STRUKTURA E SEKRETARIATIT EKZEKUTIV TE
KOMITETIT SHQIPETAR TE BIRESIMEVE**

Skema



ORGANIKA E SEKRETARIATIT EKZEKUTIV TË
KOMITETIT SHQIPTAR TË BIRËSIMEVE

I. KRYETARI	1
Sekretare e kryetarit	1
II. Sektori i psikociologjisë	4
Përgjegjës i sektorit	1
Sociologë specialist	2
Psikolog	1
II. Sektori juridik	1
Jurist (këshilltar juridik)	1
III. Sektori i financës	1
Specialist financiar	1
Shofer i Departamentit	2
PUNONJËS GJITHSEJT 10	

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.325, datë 22.8.1997

**PËR CAKTIMIN E PERSONAVE JURIDIKË QË DO T'I NËNSHTROHEN DISPOZITAVE
TË LIGJIT NR.8227, DATË 30.7.1997 "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.8215, DATË 9.5.1997 "PËR KONTROLLIN FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË
JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË"**

Në bazë të nenit 5 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrolli financiar dhe administrimi, në bazë të dispozitave të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" dhe të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", do t'i nënshtrohen personat juridikë:

- VEFA HOLDING
- SILVA
- KAMBERI SHPK

- CENAJ
 - M.LEKA
 - BENO
 - GLOBAL FOODS
- që më poshtë do të quhen subjekte kontrolli.

2. Për subjektet e mëposhtme:

- GJALLICA
- SUDE
- FONDACIONI “DEMOKRACIA POPULLORE XHAFERRI”
- FONDACIONI “POPULLI”,

ndaj të cilave kanë filluar çështjet penale, organet e prokurorisë ose të gjykatës mund të thërrasin, me cilësinë e ekspertit, ekspertët kontabël të pavarur që caktohen sipas ligjit.

3. Si administratorë të subjekteve të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, janë këto persona:

Për subjektin e kontrollit VEFA HOLDING

1. Azem Hyka
2. Fuat Kadillari
3. Saniye Tafa

Për subjektin e kontrollit SILVA

1. Fahri Domi
2. Mihal Kerzezi
3. Luan Kamberi

Për subjektin e kontrollit KAMBERI

1. Esmeralda Moci
2. Nelson Hicka
3. Viktor Frashëri

Për subjektin e kontrollit CENAJ

1. Adrian Liko
2. Ilirjana Leno
3. Gani Limanaj

Për subjektin e kontrollit M.LEKA

1. Artan Xhiali
2. Mimoza Sula
3. Fatime Mica

4. Administratorët e caktuar, sipas parashikimeve të pikës 3 të këtij vendimi, janë me cilësinë e një administratori të përkohshëm dhe e pushojnë ushtrimin e kompetencave të tyre deri në daljen e një vendimi për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave.

Në rastet kur administratorët e caktuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, largohen vetë nga detyra ose kur vendi i tyre mbetet bosh në përputhje me ligjin, caktohen administratorë të tjerë sipas radhës së listës së administratorëve rezervë, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

5. Subjektet e kontrollit, të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, janë të detyruara të vënë në dispozicion të ekspertëve kontabël të pavarur dhe të administratorëve gjithë dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e funksioneve të tyre, si dhe të japin të dhëna për të bërë identifikimin e personave të lidhur me ta në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””.

6. Administratorët e subjekteve të kontrollit duhet t’i paraqesin Këshillit të Ministrave emrat e personave të lidhur me subjektet e kontrollit, të cilët, në bazë të nenit 5 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave

juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, duhet t’i nënshtrohet kontrollit financiar dhe administrimit.

7. Ministria e Brendshme të marrë masa për të siguruar punën e administratorëve të emëruar në bazë të këtij vendimi, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

LISTA E ADMINISTRATORËVE REZERVË

1. Berti Pashko
2. Diana Golemi
3. Hamlet Daka
4. Mihal Ziu
5. Ermira Ruco
6. Romeo Mitri
7. Ingegerta Bebi

VENDIM Nr.335, datë 2.9.1997

PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasaportat diplomatike dhe të shërbimit lëshohen vetëm nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë.

2. Pasaportat diplomatike dhe të shërbimit nënshkruhen nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme ose nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Traktateve dhe Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo me autorizim të të mësipërmëve, nga titullari i përfaqësisë diplomatike jashtë shtetit.

3. Pasaportat diplomatike u jepen për të dalë jashtë shtetit personave që bëjnë pjesë në këtë kategori:

Gjatë ushtrimit të funksionit ose misionit të tyre:

- Presidentit të Republikës;
- Kryetarit dhe zëvendëskryetarëve të Kryesisë së Kuvendit Popullor;
- Kryetarit të Këshillit të Ministrave, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Qeverisë;
- Deputetëve të Kuvendit Popullor;
- Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave;
- Kryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit;
- Bashkëshortëve, djemve të mitur deri në 18 vjeç dhe vajzave të pamartuara që bashkëjetojnë me Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryetarin e Këshillit të Ministrave dhe anëtarëve të personelit diplomatik ose konsullor të Republikës së Shqipërisë, që janë jashtë vendit;

- Bashkëshortëve të anëtarëve të Qeverisë;
- Bashkëshortëve të zëvendëskryetarëve të Kryesisë së Kuvendit Popullor;
- Anëtarëve të Gjykatës së Kasacionit;
- Prokurorit të Përgjithshëm;
- Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë;
- Anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
- Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar;
- Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë;

- Kryetarëve të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin Popullor ose në Këshillin e Ministrave;
 - Anëtarëve të personelit diplomatik e konsullor të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit;
 - Funkionarëve të karrierës diplomatike dhe konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe korrierëve diplomatikë konsullorë;
 - Funkionarëve ndërkombëtarë që kanë shtetësi shqiptare kur funksionet e tyre gjykohen të rëndësishme nga Ministria e Punëve të Jashtme;
 - Kryetarit të Akademisë së Shkencave;
 - Shefave të kabinetit dhe këshilltarëve të Presidentit, të Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor dhe të Kryeministrit;
 - Anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
 - Shefave të kabinetit të ministrave;
 - Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
 - Oficerëve që shoqërojnë jashtë vendit Presidentin e Republikës, Kryetarin, zëvendëskryetarët e Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë.
4. Me pasaportë shërbimi të pajiset kjo kategori personash:
- Zëvendësministrat;
 - Nënkryetarët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit;
 - Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 - Zëvendësprokurorët e përgjithshëm;
 - Prefektët dhe Sekretarët e Përgjithshëm të Prefekturave;
 - Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
 - Drejtorët e departamenteve pranë Këshillit të Ministrave;
 - Kryetari i Kryqit të Kuq Shqiptar;
 - Drejtori dhe nëndrejtori i ATSH-së;
 - Drejtori dhe nëndrejtori i Radiotelevizionit, drejtori i radios dhe ai i televizionit;
 - Drejtorët e bankave shtetërore;
 - Drejtori i Përgjithshëm i Telekomit;
 - Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit;
 - Drejtori i Drejtorisë së Doganave;
 - Drejtori i Qendrës së Nxitjes së Investimeve të Huaja;
 - Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komiteteve dhe drejtorët e drejtorive të përgjithshme dhe të drejtorive e agjencive të tjera në varësi të Këshillit të Ministrave;
 - Drejtorët e drejtorive në Kryeministri dhe ministri;
 - Nënkryetarët dhe sekretarët e Akademisë së Shkencave;
 - Këshilltarët e anëtarëve të Këshillit të Ministrave;
 - Korrespondentët e përhershëm të shtypit shtetëror të akredituar në vende të ndryshme;
 - Rektorët dhe zëvendësrektorët e universiteteve;
 - Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave të Shtetit;
 - Nënkryetarët, sekretarët e përgjithshëm dhe shefat e sektorit të jashtëm të partive të përfaqësuara në Kuvendin Popullor ose në Qeveri;
 - Kryetarët e komuniteteve fetare;
 - Kryetarët e partive politike që nuk përfaqësohen në Parlament ose në Qeveri;
 - Kryetarët e këshillave të rretheve dhe kryetarët e bashkive, si dhe personat e ngarkuar për marrëdhëniet me jashtë;
 - Zëvendës shefat e Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandanti i Gardës së Republikës;
 - Shoferët e Presidentit të Republikës, kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryetarit të Këshillit të Ministrave e të anëtarëve të Qeverisë, kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Prokurorit të Përgjithshëm, Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Kryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave;
 - Punonjësit administrativë e teknikë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të përfaqësive diplomatike, konsullore dhe tregtare, bashkëshortëve, djemve deri në 18 vjeç dhe vajzave të pamartuara që bashkëjetojnë me ta;
 - Drejtori, kryeredaktori dhe shefi i sektorit me jashtë të gazetave të përditshme të karakterit

informativ e politiko-shoqëror, me tirazh mbi 5000 kopje, si dhe revistave periodike të karakterit informativ, politik e social sipas përcaktimit që do të bëhet nga Drejtoria e Shtypit e Ministrisë së Punëve të Jashtme;

- Kryetari i Komitetit Olimpik, Sekretari i Përgjithshëm i FSHF-së dhe trajneri i Ekipit Kombëtar në futboll;

- Nënkryetarët dhe drejtorët e SHIK-ut;

- Zëvendësguvernatori i Bankës së Shqipërisë.

5. Pas përfundimit të shërbimit, pasaportat e shërbimit duhet të depozitohen pranë drejtorive të personelit të ministrive dhe institucioneve.

6. Në rast se mbajtësi i pasaportës diplomatike apo të shërbimit shkarkohet nga detyra, largohet nga puna apo emërohet në një detyrë tjetër, ai është i detyruar të dorëzojë pasaportën diplomatike ose të shërbimit.

Në rast mosdorëzimi të pasaportës diplomatike ose të shërbimit, Drejtoria Juridike e Konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme njofton të gjitha përfaqësitë e huaja të akredituara në Tiranë për pavlefshmërinë e pasaportës së padorëzuar. Drejtoria Juridike e Konsullore, gjithashtu, njofton për sa më lart edhe Ministrinë e Brendshme, e cila urdhëron të gjitha pikat e kalimit kufitar për moslejimin e daljes jashtë shtetit të mbajtësit të kësaj pasaporte, si dhe bllokimin e pasaportës.

7. Në rast se mbajtësi i pasaportës diplomatike apo të shërbimit e humb atë gjatë kohës që është në shërbim, do të ripajiset me pasaportë të re, vetëm pasi drejtoria e personelit të ministrisë apo institucionit përkatës të ketë dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme kërkesën, deklaratën e personit ku sqaron rrethanat e humbjes, si dhe një vërtetim të marrë nga Ministria e Brendshme ku të jetë konfirmuar se humbja e kësaj pasaporte u është bërë e njohur të gjitha pikave të kalimit kufitar.

8. Lejohet vendosja e fotografive të fëmijëve nën 16 vjeç vetëm në pasaportat e bashkëshortëve të anëtarëve të personelit diplomatik ose konsullor të Republikës së Shqipërisë.

9. Afati i vlefshmërisë së pasaportave diplomatike dhe të shërbimit duhet të jetë deri në 5 vjet. Ai mund të zgjatet 2 herë të tjera për periudha deri në 2 vjet.

10. Vetëm autoritetet e treguara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mund ta zgjatnin afatin e vlefshmërisë së pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

11. Lëshimi i pasaportave diplomatike dhe të shërbimit ose zgjatja e afatit të vlefshmërisë së tyre bëhet kundrejt pagesës sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave. Këto pagesa përballohen nga organet, institucionet ose organizmat që kërkojnë lëshimin apo zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së pasaportave për punonjësit e tyre.

12. Për shkeljen e rregullave të këtij vendimi zbatohen sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.132, datë 6.3.1993 “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, ndryshuar, me vendimin nr.288, datë 14.6.1993 dhe vendimin nr.177, datë 7.4.1995, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 10 shtator 1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Fatos Nano

VENDIM

Nr.358, datë 10.9.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.694, DATË 21.10.1996 “PËR NORMËN MËSIMORE-SHKENCORE NË SHKOLLAT E LARTA DHE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, PAGIMIN E ORËVE SUPLEMENTARE, AKTIVIZIMIN E PENSIONISTËVE DHE PUNONJËSVE TË JASHTËM NË SISTEMIN E ARSIMIT”

Mbështetur në ligjin nr.7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 27, në ligjin 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, neni 53, dhe me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.694, datë 29.10.1996, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 shfuqizohet

2. Në pikën 2 shtohet ky paragraf:

“Për rastet e jashtëzakonshme, me vendim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, shkollat e larta mund të aktivizojnë punonjës të jashtëm, që të lejohen të japin orë mësimore mbi normën e mësipërme”.

3. Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Sasia e orëve mësimore mbi normën e miratuar lejohet sipas nevojave të shkollës, por jo më shumë se 30% e normës.” Ky paragraf i shttrin efektet për vitin mësimor 1997-1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.393, datë 26.9.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.42, DATË 23.1.1995 “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, SI DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””

Me propozimin e Ministrisë së Punës e të Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun VII, pika 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 23.1.1995, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Personat që kanë humbur vendet e punës për shkak të mbylljes së subjekteve të dëmtuara nga çrregullimet e rendit publik në periudhën janar-mars të vitit 1997, mund të paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për përfitimin e të ardhurave të papunësë deri në datën 15.10.1997. Këta persona quhen të siguruar për efekte të përfitimit të të ardhurave nga papunësia edhe në rastet kur:

- Punëdhënësi i ka transferuar kontributet në llogaritë e sigurimeve shoqërore të paktën deri në fund të muajit dhjetor të vitit 1996.

- Punëdhënësi ka ndaluar nga paga e punëmarrësit kontributin e sigurimeve shoqërore për muajin janar e në vijim. Ndalesa e kontributeve vërtetohet nga punëdhënësi. Drejtoritë e sigurimeve shoqërore në rrethe të konfirmojnë vetëm periudhën, për të cilën janë paguar kontributet nga ana e punëdhënësit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.396, datë 26.9.1997

**PËR DETYRAT E GRUPIT MBIKËQYRËS TË KONTROLLIT FINANCIAR TË
PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË**

Në mbështetje të neneve 2 dhe 3 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Grupi mbikëqyrës i kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë është organ e bashkërendues pranë Këshillit të Ministrave ndërmjet administratorëve e ekspertëve kontabël dhe subjekteve që i nënshtrohen kontrollit dhe administrimit.

2. Grupi mbikëqyrës ka këto detyra kryesore:

- Ndjek, ndihmon dhe kontrollon zbatimin e drejtë e të njëjlojtë në të gjitha subjektet e kontrollit të akteve ligjore e nënligjore për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.

- Merr raporte dhe informacione periodike 10-ditore prej administratorëve të subjekteve të kontrollit për ecurinë e kontrollit financiar, problemet që dalin dhe masat që duhen marrë gjatë kontrollit financiar.

- Kryen udhëheqjen metodologjike të punës së ekspertëve kontabël dhe administratorëve të subjekteve të kontrollit, duke kërkuar zbatimin me rreptësi të dispozitave të ligjit për kontabilitetin e të standardeve ndërkombëtare në këtë fushë.

- Përgatit metodikat dhe udhëzimet në fushën e kontrollit financiar për të gjitha subjektet e kontrollit, duke kërkuar zbatimin e njëjlojtë të tyre, pavarësisht nga veçoritë dhe specifikat që ato paraqesin.

- Kërkon nga ekspertët kontabël dhe administratorët, për secilin subjekt të kontrollit, dokumentet e nevojshme financiare për numrin e kreditorëve, shumat e depozituara prej tyre, detyrimet financiare për t’u paguar, lëvizjen e parave, vlefat pasurore të objekteve në inventar, gjendjen e parave në arkë dhe bankë brenda dhe jashtë vendit, si dhe dokumente të tjera të nevojshme për transparencën e tyre.

- Kërkon nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit, si dhe nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, të dhëna të sakta lidhur me objektet që kanë privatizuar subjektet e kontrollit, listën me vlerësimet fillestare të këtyre objekteve dhe mënyrën e pagesës.

- Për shoqëritë huamarrëse që janë në proces hetimor ose gjyqësor, kërkon nga prokuroria shumat e përfituara nga subjektet politike, politikanët, deputetët, punonjësit e organeve tatimore, doganore e gjyqësore, ose nga personat e tjerë të administratës shtetërore dhe pjesëtarët e familjeve të tyre.

- Mbikëqyr respektimin e të drejtave dhe interesave pasurore të pjesëmarrësve në veprimtaritë e huamarrjes, duke bërë rekomandimet e nevojshme.

- Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit civil të Republikës së Shqipërisë nga subjektet e kontrollit, duke bashkërenduar me administratorët e këtyre subjekteve.

- Studion efektet e veprimtarisë së huamarrjes në ekonominë e vendit tonë dhe përvojën e vendeve të tjera, ku janë ndeshur dukuritë e huamarrjes, dhe mbi këtë bazë propozon zgjidhjet përkatëse.

- Ruan karakterin konfidencial për të gjitha të dhënat e marra, me përjashtim të të dhënave që janë marrë nga burimet publike të informacionit ose që janë bërë të njohura njëkohësisht edhe prej këtyre të fundit.

- Ndërhyn, sipas rastit, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin gjatë procesit të kontrollit ndërmjet subjekteve të kontrollit e administratorëve, duke informuar Këshillin e Ministrave.

- Angazhon në kryerjen e detyrave të tij specialistë të fushave të ndryshme, të cilët janë të detyruar të plotësojnë kushtet për konfliktin e interesave dhe për ruajtjen e karakterit konfidencial të të dhënave.

- Informon, sa herë që e gjykon të nevojshme, Këshillin e Ministrave për ecurinë e kontrollit

financiar, për problemet që kanë dalë gjatë ushtrimit të kontrollit, si dhe bën propozimet e nevojshme për zgjidhjen e tyre.

- Bashkërendon punën me komisionin e ekonomisë, të buxhetit, financave dhe privatizimit për sigurimin e transparencës në veprimtarinë e huamarrjes.

- I propozon grupit të punës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, për trajtimin e problemeve të transparencës së shoqërive huamarrëse dhe për ndryshime në aktet ligjore në fuqi për kontrollin e shoqërive huamarrëse.

- I propozon Këshillit të Ministrave projektligjin për skemën e shpërndarjes së parave, që do të evidencohen dhe mbliidhen nga administratorët në subjektet e kontrollit.

- I propozon Këshillit të Ministrave, sipas rastit, shkarkimin e administratorëve nga subjektet e kontrollit, kur vëren shkelje të ligjit, të kompetencave dhe të të drejtave që ato kanë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, sipas ligjit.

- Mban lidhje të vazhdueshme me organet e shtypit dhe të medias publike, jep informacione e konferenca shtypi për publikun, duke e bërë sa më të plotë transparencën e shoqërive huamarrëse.

3. Grupi mbikëqyrës, për kryejen e detyrave që dalin nga ligji, harton rregulloren e brendshme të tij.

Anëtari i grupit mbikëqyrës, i caktuar nga Këshilli i Ministrave, është përfaqësuesi i këtij grupi.

Anëtarët e grupit mbikëqyrës mbliidhen për të shqyrtuar raporte e informacione të ndryshme dhe për t'ia paraqitur ato Këshillit të Ministrave sa herë që shihet e nevojshme dhe siç përcaktohet në rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij. Kur ndërmjet anëtarëve të grupit mbikëqyrës ka mendime të kundërta, materiali i paraqitet Këshillit të Ministrave me mendimet e veçanta të tyre.

4. Grupi mbikëqyrës, për kryejen e detyrave që dalin nga ligji, ka strukturën e tij organizative dhe pagat sipas lidhjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Klasifikimi dhe përfshirja e administratorëve të subjekteve të kontrollit në një nga grupet e nivelit të pagave të përcaktuara sipas lidhjes nr.3 të këtij vendimi, është në kompetencë të grupit të mbikëqyrës, i cili mban parasysh shtrirjen dhe përmasat e aktivitetit të kompanive huamarrëse, numrin e kreditorëve etj.

5. Për pagat e punonjësve të grupit dhe administratorëve të subjekteve të kontrollit, aparatit të Këshillit të Ministrave, në buxhetin e vitit 1997, i shtohen 7.0 milionë lekë, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ministria e Brendshme të marrë masa për të siguruar punën e grupit mbikëqyrës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Fatos Nano

Lidhja nr.1

STRUKTURA ORGANIZATIVE E GRUPIT MBIKËQYRËS

- | | |
|-----------------------------------|--------|
| - Anëtarë të grupit mbikëqyrës | 3 veta |
| - Jurist | |
| - Ekonomist-arkivist | |
| - Përkthyes (anglisht-frëngjisht) | |
| - Sekretar i grupit mbikëqyrës | |
| - Shofer në grupin mbikëqyrës | |

VENDIM
Nr.397, datë 26.9.1997

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT PËR
MISIONIN E ASISTENCËS DOGANORE TË KOMISIONIT EUROPIAN NË SHQIPËRI**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të Memorandunit të Mirëkuptimit për Misionin e Asistencës Doganore të Komisionit Europian në Shqipëri.
2. Autorizohet Ministri i Financave, ose një person tjetër i autorizuar prej tij, të nënshkruajë në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë Memorandumin e Mirëkuptimit.
3. Furnizimi me ujë dhe me karburant i anijeve që do të vijnë në kuadrin e Misionit të Komisionit Europian, të përballohet nga Ministria e Mbrojtjes.
Shpenzimet e fjetjes për anëtarët e Misionit, gjatë periudhës së qëndrimit në Shqipëri, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes (kapiteneritë) të nxjerrin rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.398, datë 26.9.1997

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.99, DATË
24.2.1997 “PËR PËRCAKTIMIN E DISA KRITEREVE LOKALE PËR TRAJTIMIN ME
NDIHMË EKONOMIKE TË FAMILJEVE QË JANË NË VËSHTIRËSI EKONOMIKE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.99, datë 24.2.1997 “Për përcaktimin e disa kriterëve lokale për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve që janë në vështirësi ekonomike”, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 26 shtator 1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.429, datë 20.10.1997

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË
SHQIPËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrit të Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e protokollit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës të

Grequisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, i cili i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik që, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe ministrinë përkatëse:

a) të përgatisin projektet që do të financohen në kuadrin e protokollit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve;

b) të përgatisin dhe negociojnë me palën greke për kushtet, skemat financiare, detajet teknike dhe marrëveshjet përfundimtare të projekteve e të kredive që do të nënshkruhen ndërmjet dy palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Fatos Nano

PROTOKOLL

MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Qeveritë e Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë,

Duke marrë në konsideratë:

a. Gatishmërinë dhe angazhimin e Qeverisë greke për të mbështetur Qeverinë shqiptare për të kaluar situatën e tanishme ekonomike;

b. Programin koherent të një kredie të butë prej 20 bilionë dhrami greke (GDR) në mbështetje të ekonomisë shqiptare, i cili u përgatit në përputhje me propozimet e Qeverisë shqiptare, dhe

c. Shumën prej 2 bilionë GDR, brenda kuadrit koherent të sipërpërmendur të mbështetjes ekonomike prej 20 bilionë GDR, tashmë të dhënë nga Greqia gjatë vizitës së Ministrit të Punëve të Jashtme, z.Paskal Milo në Athinë në 12 shtator 1997,

ranë dakord për sa më poshtë vijon:

1. Qeveria greke do t'i japë Qeverisë shqiptare një kredi prej 3 bilionë GDR, me qëllim përballimin e problemeve të karakterit makroekonomik dhe në mënyrë specifike për mbështetjen e bilancit të pagesave. Kredia do të kanalizohet nëpërmjet bankave qendrore të të dy vendeve. Emërtimi i monedhës është GDR dhe kushtet e kredisë janë si vijon:

Maturia	20 vjet
Përqindja e interesit	4%
Pagimi i interesit	me këste 6-mujore
Pagimi i principalit	në datën e maturimit

Ministria e Ekonomisë Kombëtare të Greqisë dhe Ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik të Shqipërisë, në bashkëpunim me bankat qendrore të të dy vendeve do të përgatisin detajimet e marrëveshjes së kredisë, në emër të qeverive respektive.

2. Pjesa e mbetur prej 15 bilionë GDR do të alokohet si vijon:

a) 5 bilionë GDR për programet e infrastrukturës sociale;

b) 5 bilionë GDR për programet për ndërtime shtëpish;

c) 5 bilionë GDR për mbështetjen e sektorit privat, me prioritet atyre ndërmarrjeve të interesuara greke, shqiptaro-greke, dhe shqiptare, të cilat u dëmtuan gjatë trazirave të fundit në Shqipëri dhe që dëshirojnë të vazhdojnë aktivitetin dhe punën e tyre në Shqipëri.

Kushtet e kësaj pakete prej 15 bilionë GDR janë si vijon:

Maturia	25 vjet
Përqindja e interesit	5%
Periudha mospagimit	7 vjet
Pagimi i interesit	me këste 6-mujore
Pagimi i principalit	me këste 6-mujore

Seleksionimi i projekteve që do të financohen në kuadrin e programeve të sipërpërmendura do të vendoset nga të dyja palët, bazuar në propozimet konkrete që do të paraqiten nga pala shqiptare. Propozimet për projekte do të përfshijnë objektivat e projekteve, parametrat e shpenzimeve dhe grafiku kohor i zbatimit.

Pagimi i kredisë do të bëhet nëpërmjet një mekanizmi zbatimi, i cili miratohet nga Ministria e Ekonomisë Kombëtare të Greqisë dhe autoritetet kompetente shqiptare.

Elementet e këtij protokoll mund të jenë propozimi grek në Konferencën e Donatorëve, në 22 tetor, në Bruksel.

Nënshkruar në Tiranë, më 15 tetor 1997, në dy kopje në gjuhën angleze.

Znj. Ermelinda Meksi
Ministër Shteti për Zhvillimin
dhe Bashkëpunimin Ekonomik të Shqipërisë

Mr. Alexandros Baltas
Zëvendësministër i Ekonomisë
Kombëtare të Greqisë

VENDIM
Nr.455, datë 20.10.1997

**PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT OPERACIONAL TË VENDIT (COP)
PËR VITIN 1997 NË KUADRIN E PROGRAMIT KOMBËTAR PHARE TË KOMISIONIT
EUROPIAN**

Me propozimin e Ministrit të Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit operacional të vendit (COP) për vitin 1997 për shumën grant 31.5 milionë ECU në kuadrin e programit kombëtar Phare të Komisionit Europian.

2. Miratimin e një shume grant 2.5 milionë ECU, sipas një memorandumit të veçantë financiar për programin Tempus. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e programit Tempus.

3. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin Popullor për zbatimin e projektit të administratës publike, Ministria e Brendshme për zbatimin e projektit për policinë, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mjedisit dhe Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit për zbatimin e projektit të mjedisit, Instituti i Ekspertëve Kontabël për projektin e asistencës kontabël, Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit për zbatimin përkatësisht të projektit të transportit dhe të projektit për furnizimin me ujë dhe kanalizime, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për projektin e bujqësisë, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe e Gruas dhe Fondi i Zhvillimit Shqiptar për projektin e zhvillimit të komuniteteve lokale.

4. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik të nënshkruaj memorandumin financiar për COP-1997, në emër të Qeverisë shqiptare, me Komisionin Europian.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.456, datë 20.10.1997

**PËR MIRATIMIN E GRANTIT JAPONEZ PËR PËRGATITJEN E PROJEKTIT
“RIMËKËMBJA E INDUSTRIË PRIVATE”, QË FINANCIOHET NGA BANKA
BOTËRORE**

Në bazë të pikës 2 të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë grantin japonez prej 455,380 USD, për ngritjen e Agjencisë Shqiptare të Garancive në kuadrin e projektit “Rimëkëmbja e industrisë private”.
 2. Autorizohet Ministri i Financave të nënshkruajë Marrëveshjen e grantit japonez ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit si administratorë të këtij granti, si dhe gjithë dokumentet e tjera të lidhura me të.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e marrëveshjes së grantit dhe ndjekjen e procedurave përkatëse.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano**

**VENDIM
Nr.481, datë 10.11.1997**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.208, DATË
8.5.1997 “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT PËR MËSUESIT
DHE NXËNËSIT QË PUNOJNË DHE MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT”**

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.208, datë 8.5.1997, në pikën 1, pas fjalës “të nxënësve” shtohen fjalët “të arsimit të detyrueshëm”.
2. Pika 4 ndryshohet si vijon:
“Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, duke u mbështetur edhe në mendimin e këshillit të rrethit, të aplikojë mbi tarifat ekzistuese të transportit sipas linjave, shtesat:
Për linjat me kategori mesatare rrugore II-III, shtesë 20% mbi tarifat e miratuara.
Për linjat me kategori rrugore mesatare III-V, shtesë 30% mbi tarifat e miratuara.
Për linjat me kategori mesatare rrugore mbi V, shtesë prej 45% mbi tarifat e miratuara.”
3. Shtohet pika 4/a si vijon:
“Për transportin e arsimtarëve dhe nxënësve të arsimit të detyrueshëm, kur nuk ka linja të rregullta transporti interurban, autorizohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të marrë mjete transporti në dispozicion me qira nga subjektet fizike ose juridike private të transportit në bazë të tenderit të zhvilluar për këtë qëllim nga drejtoria arsimore”.
4. Efektet financiare shtesë që rrjedhin nga ndryshimet e mësipërme, përballohen nga buxheti i miratuar i vitit 1997 për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.483, datë 10.11.1997

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT ITALIAN NDËRMJET SHQIPËRISË
DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË ZHVILLIMIT (IDA) , SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE GRANT PËR PROJEKTIN E RRUGËVE RURALE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së grantit italian ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), si administratore e fondeve grant të dhëna nga Republika e Italisë, për shumën 15 920 314, 58 USD, për financimin e pjesshëm të projektit të rrugëve rurale.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për përdorimin e shumës së grantit italian të akorduar nga kjo marrëveshje.

3. Autorizohet Ministri i Financave, ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, për nënshkrimin e marrëveshjes së grantit italian dhe dokumenteve të tjera lidhur me të.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.502, datë 24.11.1997

**PËR PAGIMIN E SHUMAVE DHE DIFERENCAVE TË PENSIONEVE PËR PERIUDHË TË
KALUAR PËR TË PËRNDJEKURIT POLITIKË**

Në zbatim të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” dhe të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 6.3.1993 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.2, datë 4.1.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të fillojë likuidimi përfundimtar i shumave të pensioneve për periudhë të kaluar dhe i diferencave të pensioneve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”.

2. Pagesat e pensioneve dhe diferencave të pensioneve për të përndjekurit politikë në shumën 167.3 milionë lekë do të përballohen:

- Në shumën 140 milionë lekë me fondet e akorduara për këtë qëllim nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1997.

- Në shumën 27.3 milionë lekë me fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në zërin “transferime nga Buxheti i Shtetit”.

3. Radha e likuidimit përfundimtar të pensioneve dhe diferencave të pensioneve do të jetë sipas radhës së tërheqjes së kësteve të mëparshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.509, datë 24.11.1997

**PËR KOMPENSIMIN E TOKËS BUJQËSORE TË ZËNË NGA NDËRTIMET PA LEJE PËR
FAMILJET E FSHATIT BULCESH**

Më propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e masës së kompensimit të tokës bujqësore të zënë nga ndërtimet pa leje prej 34.7 hektarësh me vlerë totale 138.8 milionë lekë për familjet e fshatit Bulcesh.
2. Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit të programojë fondet për kompensimin e tokës bujqësore të fshatit Bulcesh nga Buxheti i Shtetit për vitin 1997 në masën 70 milionë lekë dhe për tremujorin e parë të vitit 1998 në masën 68.8 milionë lekë.
3. Ngarkohet komuna e Zall-Bastarit në Tiranë për zbatimin e këtij vendimi dhe kryerjen e pagesave të familjeve në fshatin Bulces, sipas listës që i është bashkëngjitur këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.510, datë 24.11.1997

**PËR KRITERET E VENDOSJES NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE TË
PËRKUJDESJES SHOQËRORE DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PRANIM**

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror" dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vendosjen dhe lëvizjen e personave në institucionet e përkujdesjes shoqërore marrin iniciativë:
 - a) Prindërit ose të afërmit e personit;
 - b) kujdestarët e personit, kur nuk janë gjallë prindërit;
 - c) të interesuar të tjerë (të autorizuar);
 - ç) institucioni i mëparshëm;
 - d) seksioni përkatës i ndihmës dhe i përkujdesjes shoqërore dhe institucione të tjera nëpërmjet seksionit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore.
2. Në shtëpitë e foshnjës dhe të fëmijëve pranohen:
 - a) Fëmijë që nuk kanë gjallë asnjë nga prindërit dhe nuk kanë persona të tjerë të afërt që marrin përsipër vullnetarisht rritjen dhe edukimin e tyre.
 - b) Fëmijët e lindur jashtë martese, të cilët për rrethana të caktuara nuk mund t'i rritë nëna.
 - c) Fëmijë, prindërve të të cilëve, të dyve së bashku ose njërit (dhe tjetri ka vdekur), u është hequr e drejta prindërore me vendim gjyqi dhe gjykata me vendim të formës së prerë ka përcaktuar vendosjen e tyre në institucionet e përkujdesit shoqëror.
 - ç) Fëmijët të cilët braktisen dhe nuk u dihet identiteti.
 - d) Fëmijë, për cilët gjykata me vendim të formës së prerë vendos të sistemohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore dhe fëmijë që mbeten përkohësisht pa prindër dhe nuk ka

persona të tjerë të afërt që marrin përsipër vullnetarisht rritjen dhe edukimin e tyre ku përfshihen këto raste:

- Kur prindërit, të dy ose vetëm njëri (dhe tjetri nuk është gjallë ose nuk është në gjendje ekonomike ta mbajë fëmijën, çka duhet të jetë e vërtetuar me dokumente), shtrohen në spital, sanatorium ose dërgohen për kurim jashtë shtetit. Në këtë rast vendosja e fëmijës në institucione bëhet për një periudhë kohe deri në 6 muaj.

- Kur prindërit burgosen të dy ose vetëm njëri (dhe tjetri nuk është gjallë ose nuk është në gjendje ekonomike ta mbajë fëmijën, çka duhet të jetë e vërtetuar me dokumente përkatëse). Në këtë rast vendosja e fëmijës në institucionet e përkujdesjes shoqërore bëhet për të gjithë periudhën e kohës kur të dy prindërit ndodhen në burg apo njëri është në burg dhe tjetri nuk është gjallë dhe deri në përmirësimin e kushteve ekonomike të prindit tjetër, kur vetëm njëri prind është në burg dhe tjetri nuk ka mundësi ekonomike ta mbajë fëmijën.

e) Në shtëpitë e foshnjës dhe të fëmijëve mund të pranohen (në varësi nga kapaciteti i institucionit dhe graviteti i rastit) fëmijë të familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, ose që kanë kriza familjare, si divorci, martesë e rimartesa, si dhe probleme të tjera të forta sociale. Në këtë rast vendosja e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror bëhet në një periudhë kohe deri në përmirësimin e kushteve socialekonomike të familjes. Gjithashtu në këto institucione mund të pranohen edhe fëmijë të braktisur, prindërit e të cilëve kanë emigruar ose do të emigrojnë jashtë shtetit për arsye ekonomike.

Në shtëpitë e foshnjës e të fëmijëve nuk pranohen fëmijë distrofë apo handikapatë, edhe në raset kur ata i plotësojnë kriteret e përmendura më sipër.

Mosha e pranueshme për t'u vendosur në shtëpitë e foshnjës dhe të fëmijëve është nga mosha 0-14 vjeç, e ndarë përkatësisht:

- Nga 0-3 vjeç vendosen në shtëpinë e foshnjës.

- Nga 3-6 vjeç vendosen në shtëpinë e fëmijëve parashkollor.

- Nga 6-14 vjeç vendosen në shtëpinë e fëmijëve shkollor.

Në rastin kur fëmija nuk ka mundur të kryejë arsimin 8-vjeçar, mbahet deri në moshën 17 vjeç.

Dokumentacioni për vendosjen në shtëpitë e foshnjës:

- certifikatë e lindjes së fëmijës (origjinali ose kopje e noterizuar);

- fotografitë e fëmijës (2 copë);

- certifikatë e gjendjes familjare (origjinali ose kopje e noterizuar);

- certifikatë e vdekjes së prindërve (origjinali ose kopje e noterizuar);

- kopje e noterizuar e vendimit të gjyqit për heqjen e së drejtës prindërore;

- deklarata e noterizuar e nënës ose në pamundësi e drejtorit të maternitetit që vërteton braktisjen e fëmijës;

- epikriza shëndetësore, kartelë mjekësore me të dhënat laboratorike dhe për vaksinimin;

- analiza për SIDA-n dhe hepatitin;

- një dokumentacion për gjendjen shëndetësore të prindërve të fëmijës, nëse është e mundur;

- procesverbali i dorëzimit të fëmijës nga materniteti në shtëpinë e foshnjës;

- procesverbali dhe urdhri i transferimit të fëmijës, në rastin e lëvizjes së tij nga një institucion në tjetrin;

- certifikatë e divorcit të prindërve ose e martesës së njërit apo të dy prindërve;

- dokumenti i shkollës që ka ndjekur fëmija;

- deklaratë me shkrim për dhënien e pëlqimit të prindërit ose të ngarkuarit ligjor, për vendosjen e fëmijës në institucion.

3. Në institucionet e personave të paaftë pranohen:

a) të paaftë mendorë;

b) të paaftë fizikë;

c) të paaftë sensorë.

Paaftësia e grupeve të përcaktuara më lart, duhet vërtetuar nga KMCAP.

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pranuar në institucionet e personave të paaftë:

- certifikatë e lindjes së personit;
- vendimi i komisionit mjekësor për përcaktimin e paaftësisë;
- certifikatë e gjendjes familjare;
- epikriza shëndetësore;
- fotografi (2 copë);
- vërtetim për gjendjen ekonomike të familjes, si dhe të ardhurat personale të personit të paaftë, dhënë nga seksioni përkatës i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore;
- kopje e vendimit të këshillit të bashkisë apo komunës për vendosjen e personit të paaftë në institucion;
- kërkesë për sistemim të personit të paaftë në institucion (miratuar nga ky i fundit, kur ai është në gjendje), e bërë nga familja, kujdestari, ndonjë person i afërt apo i interesuar, ose nga administratori shoqëror i njësisë ku banon personi i paaftë;
- dokumenti i shkollës që ka ndjekur personi i paaftë.

4. Në institucionet e personave të moshuar pranohen:

Persona mbi moshë pune, kur ata kanë qenë në marrëdhënie pune sipas përcaktimit të bërë në ligjin për sigurimet shoqërore dhe që:

- janë të braktisur dhe nuk kanë strehim e të ardhura, ose
- janë të vetmuar e të pamundur, të cilët nuk kanë njeri të familjes apo ndonjë të afërm që të marrë përsipër vullnetarisht të kujdeset për ta, ose
- kërkojnë të hyjnë në institucion të detyruar nga disa rrethana të caktuara në familjet e tyre.

Në institucionet e personave të moshuar mund të pranohen persona që nuk kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara më sipër, me përjashtim të kushtit të parë, por që janë në moshë jo nën 55 vjeç gratë dhe nën 60 vjeç për burrat. Vendosja e tyre në institucione është edhe në varësi nga kapaciteti i institucionit.

Në institucionet e personave të moshuar mundësisht të mos sistemohen në të njëjtin mjedis personat e shëndoshë me personat e paaftë në varësi nga kushtet aktuale të institucioneve ekzistuese.

Për institucionet e reja të personave të moshuar, qofshin këto publike apo private, duhet të parashikohet që në konstruksion sistemimi i veçantë i personave normalë nga handikapatë.

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pranuar në institucionet për personat e moshuar:

- kërkesë me shkrim nga vetë personi ose familja, të afërt të tij apo administratori shoqëror i njësisë ku banon, me miratimin e personit të moshuar;
- certifikatë e gjendjes civile;
- certifikatë e gjendjes familjare;
- raport mjekësor që përcakton gjendjen shëndetësore të personit të moshuar;
- vërtetim nga sigurimet shoqërore, nëse përfiton pension pleqërie apo ndonjë lloj tjetër pensioni;
- vërtetim nga administratori i njësisë së ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore për gjendjen ekonomike të familjes së personit të moshuar;
- kopje e vendimit të këshillit të bashkisë a komunës për vendosjen e personit në institucion.

5. Personat kanë të drejtë të sistemohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore brenda një periudhe prej 6 muajsh, e cila mund të zgjatet deri në një vit nga data e bërjes së kërkesës së tyre. Bën përjashtim nga ky rregull periudha e sistemimit të fëmijëve nga materniteti në shtëpinë e foshnjës, e cila është 7 ditë nga dita e lindjes së fëmijës, por që mund të zgjatet deri në një muaj, në varësi nga gjendja shëndetësore e fëmijës, nga nevoja e trajtimit në kushte të veçanta të tij dhe vështirësitë e mundshme që paraqet sistemimi i fëmijës në shtëpinë e foshnjës.

6. Në vendosjen e personave në institucionet e përkujdesjes shoqërore do të kenë përparësi personat që vijnë nga familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, familje me probleme të mprehta sociale, si dhe personat e vetmuar, të braktisur dhe pa të ardhura.

7. Komisioni qendror pranë Administratës së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale shqyrton dhe merr vendim lidhur me kërkesat për sistemimin në institucionet e përkujdesjes shoqërore të paraqitura nga administratat rajonale të shërbimeve sociale, pasi këto të fundit të kenë verifikuar kërkesat e paraqitura nga seksionet e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki dhe komuna.

8. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranim, të përcaktuara në këtë vendim, janë të detyrueshme për të gjitha institucionet publike të përkujdesjes shoqërore të drejtuara në nivel qendror

e lokal, si dhe për institucionet private.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.513, datë 24.11.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.250, DATË 16.4.1996 “PËR PROCEDURAT E PRIORITETET NË ZBATIM TË LIGJIT NR.8030, DATË 15.11.1995 “PËR KONTRIBUTIN E SHITETIT PËR FAMILJET E PASTREHA””

Më propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250, datë 16.4.1996, në pikën 1.1 afati “15 maj 1996” bëhet “31 dhjetor 1997...”, kurse në pikën 1.2 afati “30 maj 1996” bëhet “30 maj 1998...”.
2. Brenda afateve të pikës 1 të këtij vendimi, lejohet dërgimi nga ana e organeve të pushteteve lokale në Bankën e Kursimeve dhe Entin Kombëtar të Banesave edhe i listave pjesore sipas radhës prioritare të familjeve të pastreha, duke respektuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.538, datë 4.12.1997

PËR SHPALLJEN E UJËSJELLËSIT TË BOVILLËS SI OBJEKT I RËNDËSISHËM SHTETËROR

Në bazë të ligjit 7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ujësjiellësi i Bovillës shpallet objekt i rëndësishëm shtetëror dhe merret në ruajtje nga Ministria e Brendshme me postë policie.
Objekti i ruajtjes do të jetë sheshi i impiantit të pastrimit, depoja e ujit në vendin e quajtur

Kodra e Kuqe në fshatin Babrru, si dhe linja e ujësjellësit përgjatë rrugës së fshatit Zall-Herr deri në digën e Bovillës me gjatësi rreth 15 km.

2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të caktojë një fond prej 7.5 milionë lekësh në vit për 20 punonjës policie, i cili t'i kalojë Ministrisë së Brendshme për ruajtjen e objektit. Këto fonde të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit të akorduara për ujësjellësin e Bovillës si kosto lokale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VENDIM
Nr.549, datë 27.11.1997

PËR IMPORTIMIN E KRIPËS SË GJELLËS SË JODIZUAR DHE PRODHIMIN E SAJ NË VËND

Për parandalimin dhe korrigjimin e pamjaftueshmërisë së jodit në organizëm, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e importimit vetëm të kripës së gjellës së jodizuar.
 2. Nivelet e pranueshme të jodit në kripën e gjellës të jodizuar në pikat e hyrjes së doganave janë 40 mg jod për kg kripë.
 3. Niveli më i ulët i pranueshëm i jodit në kripën e gjellës të jodizuar në kohën e tregtimit është 20 mg jod për kg kripë.
 4. Personat juridikë vendas ose të huaj që marrin përsipër të prodhojnë kripë gjelle të jodizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, detyrohen ta prodhojnë atë në nivelin 40 mg jod për kg kripë.
 5. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mjedisit, në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik, përgatit materialet për sensibilizimin e popullsisë për domosdoshmërinë e përdorimit të kripës së gjellës të jodizuar, si dhe për rastet e mundshme të efekteve negative.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdolloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 9.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë